



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Prilbjen/Prodato Received/Delivery	25.07.2022	2	viti god veçr
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMENK	4296/2022		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.681/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.A.nr.755/2021 të datës 31.05.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.39/2020 të datës 18.02.2020 të parashtruar nga ankuesja me adresë lagjja Komuna e Prishtinës, kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KA.nr.02/2020 të datës 22.01.2020, në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** ankesa me numër A.Nr.39/2020 e datës 18.02.2020, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi** Vendimi KA.nr.02/2020 i datës 22.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 18.02.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 391/2020 të regjistruar me numër A.nr. 39/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.02/2020 i datës 22.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 24.02.2020, ankesën e ankueses e ka dërguar për përgjigje në ankesë tek Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa me datën 26.02.2020 me numër protokollit 514/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa me datën 07.05.2020 me numër protokoll 812/2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative me datën 19.07.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1575/20, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 23.07.2021 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 07.05.2020, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 18.02.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.08.2021 përmes Njoftimit me numër protokoll 4136/2021, ka njoftuar ankuesen se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.Nr.681/2021 të datës 23.07.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, dhe ka udhëzuar të njëjten mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata e Apelit të Kosovës Departamenti për Çështje Administrative me datë 31.05.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.A.755/2020, me të cilin ka Refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses të datës 04.08.2021, ndërsa e ka vërtetuar Aktgjykimin me numër A.nr.1575/20 të datës 19.07.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:391/2020 të datës 18.02.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.A.nr.755/2021 i datës 31.05.2022 i Gjykatës së Apelit të Kosovës Departamenti për Çështje Administrative i njëjti në Këshill është pranuar me datë 22.06.2022 me numër protokoll 3629/2022; Ankesë e parashtruar nga ankuesja për Gjykatën e Apelit të Kosovës Departamenti për Çështje Administrative e datës 04.08.2021; Fletëkthesë e datës 10.08.2021; Fletëkthesë e datës 11.08.2021; Njoftim me numër protokoll 4136/2021 i datës 06.08.2021; Njoftim me numër protokoll 4137/2021 i datës 06.08.2021; Aktgjykimin A.nr.1575/20 i datës 19.07.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i njëjti në Këshill është pranuar me datë 23.07.2021 me numër protokoll 3891/2021; Fletëkthesë e datës 24.08.2020; Njoftim me numër protokoll 812/2020 i datës 07.05.2020; Fletëkthesë e datës 25.02.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 24.02.2020; Përgjigje në ankesë e datës 26.02.2020; Akt Emërim i S.S. me nr.reference 122 i datës 17.05.2013; Vendimi KA.nr.02/2020 i datës 22.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesë për rishikim të pagës së S.S.M. në pozitën e Shef i shërbimeve të përgjithshme në NJIGJ. e datës 18.10.2019; e-mail nga S.S. për V.L. i datës 06.04.2018; Ankesë e parashtruar nga ankuesja për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me nr.01/1122 e datës 30.12.2019; Procedimi në sistemin e pagave Këshilli Gjyqësor i Kosovës me nr.496 i datës 13.02.2018; Pliko me nr. 03/237 e datës 26.02.2020; e-mail nga F.K. për C.Z. i datës 05.07.2022; e-mail nga C.Z. për F.K. i datës 05.07.2022; Vendim i KGJK.nr.417/2021 i datës 29.12.2021; Rregulloren Nr.13/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë e Shqyrtimit të Performancës së Gjyqësorit e datës 20.08.2015; Organogrami i NJSHPGJ; Parashtrësë e ankueses për ankesën A.nr.39/2020 e datës 18.02.2020 e njëjta është pranuar në Këshill me datë 13.07.2022; Formulari i regjistrimit të ankesës me nr. 00003 i datës 18.02.2020; Padi e parashtruar nga ankuesja në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative e datës 24.09.2020; Konkurs i brendshëm (Avancim) Nr.03/2019 SKGJK i datës 12.09.2019; Rregullore Nr.12/2015 për



Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 20.08.2015; Organogrami i SKGJK-së;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesja është e punësuar sipas Akt Emërimit me nr.03-122 të datës 17.05.2013 në pozitën "Shefe e shërbimit të përgjithshëm" në Departamentin Njësia për Shqyrtimin e Performancës së Gjyqësorit. Më datë 18.10.2019 përmes shkresës me numër reference 01/846 mbikqyrësi i drejtëpërdrejt i ankueses i është drejtuar Drejtorit të SKGJK-së me kërkesë për rishikim të pagës së për pozitën Shefe e shërbimit të përgjithshëm, por nga i njëjti nuk ka marrë përgjigje nga ana organit të punësimit. Ankuesja e pakënaqur ka parashtruarë ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për harmonizim të koeficientit të pagës sipas Vendimit të KGJK-së nr.566 të datës 27.12.2017 dhe pagesën retroaktive të diferencës së pagës. Komisioni për për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka nxjerr vendim me numër KA.nr.02/2020 të datës 22.01.2020 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për harmonizim të koeficientit të pagës sipas Vendimit të KGJK-së nr.566 të datës 27.12.2017 dhe pagesën retroaktive të diferencës së pagës, e njëjta kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, duke i njohur të drejtën për harmonizim të koeficientit dhe pagesën retroaktive.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses duke ju referuar dispozitave të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil*, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës*, dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Në kuptim të kësaj baze ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit me nr.03-122 të datës 17.05.2013 mbanë pozitën "Shefe e Shërbimit të Përgjithshëm" në Njësinë për Shqyrtimin e Performancës së Gjyqësorit, dhe e njëjta realizon pagën në vlerën e përcaktuar në bazë të Akt Emërimit. Andaj, meqenëse Kolegji në provat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë kontratë apo akt tjetër administrativ të organit të punësimit për harmonizim të koeficientit, kështu që Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses kundër Vendimit KA.nr.02/2020 i datës 22.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është i pabazuar.

Po ashtu me Rregulloren Nr.13/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë e Shqyrtimit të Performancës së Gjyqësorit, pozita e ankueses nuk ekziston fare as në rregullore por as në organogram që është pjesë përbëse e saj dhe si rezultat i kësaj nuk mundet të barazohet me një Udhëheqës të Divizionit në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës apo ti ngritet koeficioneti i pagës.

Kolegji për shqyrtim dhe vendosje të ankesave , po ashtu duke analizuar provat e lëndës konstaton se pretendimi ankimor i ankueses lidhur me harmonizimin e koeficientit është në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili përcakton " *Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.* 2. *Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me*

propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa” andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se ndryshimet ne grada për secilin vend të punës propozohen nga institucioni përkatës në këtë rast Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa aprovohen nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse për financa.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor, për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve dhe veprimeve të organeve të administratës, konstaton se avancimi në karrierë në shërbimin civil duhet të bëhet në mënyrë transparente, të drejtë, të unifikuar, objektive dhe në bazë të meritës së kandidatëve përkatës. Nëpunësit civil ngritën në pozitë në bazë të një procedure të rregulluar dhe vetëm nëse i plotësojnë kushtet specifike të përcaktuara në aktet përkatëse ligjore dhe në bazë të meritës, prandaj ngritja në pozitë nuk bëhet në mënyrë automatike, por vetëm pas një periudhe të caktuar kohore. Ngritja në pozitë mbi kriteret të tjera që nuk bazohen në parimin e meritës është e ndaluar, andaj institucionet me rastin e ngritjes së koeficientit, duhet të respektojnë dispozitat ligjore, rregullat dhe parimet sipas legjislacionit në fuqi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.681/2021

Çlirim Zeka

Procesmbajtës


Malsore GASHI BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së